

Universiteti i Evropës Juglindore shpall:

K O N K U R S

Për zgjedhje/rizgjedhje të dy mësimdhënësve në thirrje mësimore profesionale Lektor i lartë

QENDRA E GJUHËVE

Zgjedhje/rizgjedhje të dy mësimdhënësve në thirrje mësimore-profesionale, Lektor i lartë nga lëmi: Mësim i gjuhës së huaj (gjuhë angleze);

II. Përveç kushteve të përgjithshme të parapara në Ligjin e arsimit të lartë të R. Maqedonisë, Statutit dhe Rregullores për zgjedhje apo rizgjedhje në thirrje mësimore shkencore, thirrje bashkëpunëtori dhe thirrje mësimore profesionale të UEJL, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet si vijojnë:

- Për këtë pozitë preferohet njohja e gjuhës shqipe, maqedonase dhe angleze, kurse njohja e së paku dy nga gjuhët e përmendura në nivel akademik (për mësimdhënie), është e obligueshme.
- Formularin e plotësuar për aplikim të UEJL;
- Letër interesi që tregon përvojën e kandidatit, agjendën e hulumtimit dhe aspiratat për karrierë në përputhje me strategjinë e fakultetit;
- Biografinë e plotë akademike;
- Dëshmi për përsosmëri në mësimdhënie përfshi por, jo edhe të kufizohemi vetëm në pikët në vazhdim: 1) raportet nga vëzhgimi i mësimdhënies; 2) vlerësimin nga studentët për lëndët; 3) raport nga vëzhgimi kolegjal për mësimdhënien.
- Dëshmi për përsosmëri në hulumtim përfshi edhe 1) kopje të plota të publikimeve të fundit kryesore në revistat rajonale dhe ndërkombëtare; 2) fotokopje nga kaptinat e librave, recensione akademike; 3) kopje të monografive, librave universitar, 4) përkthime nga gjuhët evropiane në gjuhët lokale.
- Dëshmi për shërbimet përfshi listën e anëtarësimit në komitete, organe dhe veprimet, etj.
- Dëshmi për hulumtim/praktikë në metodologji dhe pedagogji, duke përfshirë çdo certifikatat ose dëshmi për përfundim të suksesshëm të kurseve, programeve apo trajnime për mësimdhënie apo publikimet shkencore në këtë fushë.

III. Fillimi, mbarimi dhe orari i kohës së punës dhe shuma e rrogës (në shumë neto: 33,825 denar) për mësimdhënësit është e ndryshueshme dhe përcaktohet në pajtim me aktet e Universitetit sipas orarit të mësimdhënies dhe angazhimit të mësimdhënësit në mësimdhënie në semestër dhe thirrjes mësimore-shkencore në të cilën është realizuar zgjedhja.

IV. Për të aplikuar në këtë konkurs, kandidatët duhet të dërgojnë (vetëm përmes e-mailit): letërinteresim, biografi personale (CV), dhe formularin për aplikim (merret në ueb faqen e universitetit), diplomë (magjistraturë), listë për veprimtarinë profesionale dhe shkencore dhe nga një kopje të recensionit të parë (nëse posedojnë), të gjitha këto dokumente të theksohen në formularin për dëshmi të dokumentacionit të dorëzuar, që mund të merret në ueb faqen e universitetit, ndërsa do të dorëzohen pas seleksionimit të kandidatëve që i plotësojnë kushtet).

Dokumentet e mësipërme mund të jenë origjinale ose të vërtetuara në noter.

V. Afati i paraqitjes

Afati i dorëzimit të aplikacioneve është **8** ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Konkursi është i shpallur nga 23.02.2015 – 03.03.2015

Aplikimet vetëm përmes e-mailit: jobs@seeu.edu.mk (Aplikacion valid do konsiderohet vetëm aplikacioni i plotësuar që gjendet në ueb faqen e Universitetit, në rubrikën Konkurse. Çdo lloj tjetër forme aplikacioni nuk do merret parasysh).

VI. Adresa

Universiteti i Evropës Juglindore
Zyra e Burimeve Njerëzore
Bul. "Ilinden" nr. 335
1200 Tetovë, Maqedoni
Telefoni për kontakt: 044 356 087